

ABSTRAKTI

Përmes këtij punimi të diplomës synohet të bëhet një analizë e thellë e veprës penale lëndimi i rëndë trupor, në kuadër të kontekstit juridik të Republikës së Kosovës, me fokus të veçantë në territorin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, dega në Lipjan, për periudhën kohore 2013-2018. Qëllimi i kësaj analize është që të ofrohet një kontribut në njohurinë dhe kuptimin më të mirë të sistemit të drejtësisë penale në Kosovë sa i përketë kësaj vepre penale dhe të analizohet nëse praktikatat dhe procedurat ligjore në trajtimin e veprës penale lëndimi i rëndë trupor, përputhen me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Përmes identifikimit të sfidave dhe aspekteve tjera, synohet të ofrohet një perspektivë e pasur dhe e detajuar rreth këtij segmenti të drejtësisë penale në Kosovë. Gjatë periudhës 2013-2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, ka regjistruar 28 lëndë të veprës penale lëndimi i rëndë trupor. Kjo analizë mund të kontribuojë në kuptimin e dinamikave të kryerjes së veprave penale të lëndimeve të rënda trupore dhe në formulimin e rekomandimeve për përmirësimin e politikave dhe strategjive për parandalimin dhe trajtimin e tyre në shoqëri.

Fjalët kyçe: lëndim i rëndë trupor, vepër penale, drejtësia penale, procedurat ligjore.

